



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2025:006024  
Datë: 31.01.2025  
Numri i dokumentit: 06788017  
KPPP.nr.34/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompani Prishtina SH.P.K., me seli në Prishtinë, rruga “Selman Riza”, nr.10, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Jeton Osmani, avokat në Prishtinë, kundër debitorit Komuna e Podujevës, me seli në Podujevë, rruga “Nuhi Gashi”, p.n, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.4086/24 të datës 13.11.2024, të Përbaruesit Privat Agron Krasniqi, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datën 31.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Podujevës, ANULOHET Urdhri Përbarimor P.nr.4086/24 i datës 13.11.2024, i lejuar nga Përbaruesi Privat Agron Krasniqi dhe PËRFUNDOHET në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka caktuar urdhrin përbarimor P.nr.4086/24 të datës 13.11.2024, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.11/2023 të datës 07.07.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri, t’ia paguajë kreditorit borxhin në shumën prej 7,712.36€, me kamatë ligjore prej 8% nga data 07.07.2023 e deri në pagesën e plotë të borxhit, si dhe shpenzimet e procedurës, në të kundërtën përbarimi të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe me bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e kreditorit, ose përmes regjistrimit, vlerësimit, sekuestrimit dhe shitjes së sendeve të luajshme dhe të paluajshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se debitori nuk ka mundur për shkaqe objektive të paguaj faturën e kreditorit, sepse nga shkresa e Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, ka rezultuar se kreditori nuk i ka përmbushur kriteret ligjore siç parashihen me Ligjin nr.08/L-183 ngase për këtë faturë nuk është zbatuar asnjë dispozitë ligjore dhe nuk ka vendim pozitiv për kompensimin dhe kreditori nuk i ka kryer punët sipas planit dinamik. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit dhe të shfuqizoj në tërësi urdhrin përmbarimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se prapësimi i debitorit nuk është parashtruar për shkaqet që i parasheh neni 71 i LPP-së dhe pretendimet e debitorit janë të pabazuara dhe nuk janë argumentuar me asnjë provë të vetme. Tutje ka deklaruar se debitori me vet prapësimin e tij e ka pohuar borxhin dhe nuk e ka kontestuar asnjëherë faturën. Ka shtuar se, dokumenti i besueshëm i përmbush në tërësi kushtet e parapara nga neni 37 lidhur me nenin 38 të LPP-së dhe këtë faturë debitori e ka pranuar mirëpo nuk e ka paguar asnjëherë. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor dhe të obligohet debitori të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore sipas TOAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr.11/2023 e datës 07.07.2023 në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes*

*së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se konkret Fatura Nr.11/2023 e datës 07.07.2023, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar te debitori pasi që e njëjta nuk është protokolluar në zyrën e pranimit të debitorit - Komuna e Podujevës dhe nuk mban vulën e pranimit - protokollimit dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbarrim.

Gjykata vlerësoi faktin se fatura është e nënshkruar, mirëpo gjeti se fatura në rastin konkret i drejtohet Komunës së Podujevës, andaj e njëjta do të duhej t’i dorëzohej dhe protokollohej pranë debitorit Komuna e Podujevës.

Duke qenë se debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur, si e tillë nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit Përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.34/25, datë 31.01.2025

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.